

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë) ☐

PC STORE

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L01606034A

NUIS/NIPT

Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Pare.

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0682055468

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

financa@pcstore.al

E-mail

Administratori Vitator Mehmeti

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2025/06/04

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0672073033

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-49546-05-29-2025

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

ILLYRIAN GUARD SH.A

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

1424000

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

E-mail Zyrtar për nevojat e shoqërisë Illyrian Guard Sha

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2025/06/10

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme) ☐

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës) ☐

Tipi i kontratës

Shërbime

Data e zhvillimit të procedurës

2025/06/10

Numri i njoftimit

CN/48837/05292025

Kodi CPV

98390000-3

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.) ☐

- ? Ligji 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (LPP)
- ? Kodin e Procedurave Administrative
- ? VKM nr.285 datë 19.05.2021 “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK” (RrPP)
- ? Rekomandimin Nr.7998 të datës 24.12.2021, Agjencia e Prokurimit Publik

2. Objekti i ankesës ☐

- Modifikim i dokumentave të tenderit ☒

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj. ☐

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. ☐

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate ☐

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Shoqëria PC STORE shpk është një shoqëri e themeluar e e organizuar sipas legjislacionit tregtar shqiptar dhe e ushtron aktivitetin në fushën e shitjes, ekspertizës, konsulencës, instalimit, konfigurimit të produkteve, shërbimeve të printimit fotokopjimit zgjidhjeve në fushën e IT, etj.

Si një shoqëri tregtare PC STORE shpk e ushtron aktivitetin edhe në ofertimin tenderimin dhe lidhjen e kontratave publike sipas akteve normative në fushën e prokurimit publik në RSh.

PC STORE shpk ka një eksperiencë mbi 15 vjetare në fushën e kontratave publike, në furnizimin e institucioneve dhe enteve publike me mallra, shërbime dhe zgjidhje të ndryshme në fushën e IT/ICT.

AK Shoqëria “Illyrian Guard” Sh.A në datën 30/05/2025, për nevojat e tij, ka publikuar në SPE procedurën e prokurimit të llojit “E Hapur e Thjeshtuar- Sherbim” me nr REF-49546-05-29-2025, me objekt “E-mail Zyrtar për nevojat e shoqërisë Illyrian Guard Sha” me fond limit 1,424,000 (Një milion e katerqind e njezet e kater mijë)lek pa TVSH.

Nga këqyrja e dokumentave standarte të tenderit, kriteret e vecanta të kualifikimit, evidentojmë që janë vendosur kritere të tepërta, dhe nisur nga ky fakt, po ushtrojmë të drejtën tonë për ankim në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar.

Konkretisht kundërshtojmë përcaktimet në dokumentat e tenderit dhe kërkesat për kualifikim, si vijon:

” 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

“2.3.2 Operatori ekonomik duhet te kete:

? Certifikate Sistemi i Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit ISO/IEC 22301:2019 ose ekuivalent

? Certifikate per mbrojtjen e të dhënave personale në mjedise cloud ISO/IEC 27018:2019 ose ekuivalent.”

”2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor 2 punonjes, si më poshtë :

“1 (nje) punonjës të certifikuar ne nivel profesional per rrjetet kompjuterike(netëork)”

Theksojmë se Autoriteti Kontraktor, sipas gjykimit tonë, në hartimin e dokumentave të tenderit dhe

kritereve të vecanta për kualifikim, ka vendosur kritere të tepruara, të paargumentuara konform nevojave për realizimin e procedurës së prokurimit dhe kufizuese për konkurrencën e lirë në procedurat e prokurimit publike.

Ju lutem njihuni me faktet dhe argumentat tona që e mbështesin këtë pretendim

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

? Në lidhje me legjitimitetin ankimit

Legjitimiteti aktiv (legittimatio activa) i palës në një proces gjyqësor/administrativ nënkupton interesin legjitim dhe të vërtetë që duhet të ekzistojë ndërmjet palës dhe cështjes në shqyrtim. Interesi legjitim lidhet me të drejtën e palës për të kërkuar nëpërmjet gjykatës/organeve administrative të shqyrtimit/apelimit njohjen ose rivendosjen e një të drejte të mohuar ose cënuar prej dikujt tjetër.

Shoqëria PC STORE si Si një shoqëri tregtare që ushtron aktivitetin edhe në ofertimin tenderimin dhe lidhjen e kontratave publike sipas akteve normative në fushën e prokurimit publik në RSh., dhe objekti i procedurës në fjale është pjesë e objektit të veprimtarisë së saj që lidhet me shërbime dhe zgjidhje të ndryshme në fushën e IT/ICT.

Pra shoqëria jone është e interesuar të jetë pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit përmes paraqitjes së ofertës, ka interes legjitim për këtë procedurë dhe si i tillë, ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike të ankimit, përmes paraqitjes së ankesës njëherazi në AK dhe në KPP.

? Në lidhje me afatin e ankimit, legjitimitetin racione temporis

Në mbështetje të nenit 110 pika 1 “Afatet për ankim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, e drejta për ankim lind nga operatret e interesuar, në rastin konkret, si vijon:

“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”

Njoftimi i publikimit të procedurës së prokurimit publik, është publikuar në datën 30.05.2025, prandaj legjitimohet racione temporis, sepse e ka paraqitur ankesën brenda afatit të përcaktuar 7 ditë për ankesat, sipas ligjit, njëkohësisht në AK dhe KPP.

? Mbi themelin e ankimit

ANKESE 1:

AK Illyrian Guard në DST, kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, ka kërkuar, si vijon:

” 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilanci janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilanci e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë

raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.”

Ankesa 1 kundërshtojmë vendosjen e këtyre kritereve të cilat kufizojnë pjesëmarrjen në këtë procedurë

AK në hartimin e dokumentave të tenderit dhe kritereve të vecanta për kualifikim, konkretisht tek 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar AK ka vendosur kritere të pabazuar në ligj, konkretisht jo konform llojit të procedurës së prokurimit dhe kufizuese për konkurrencën e lirë në procedurat e prokurimit publike.

Duke u nisur nga fakti që kriteret duhen argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, i drejtohem procesverbalit të argumentimit të vendosur nga AK në SPE, ku për kriterin objekt ankimi është paraqitur argumentimi si vijon:

“Argumentimi pika 2.2.1 : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 Për tatimin mbi të ardhurat , i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike , si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, Për tatimin mbi të ardhurat , i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

Argumentimi pika 2.2.2 : Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe demonstron se Operatori Ekonomik ka aftësi financiare për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të kërkuar cilësie. Gjithashtu ky kriter është vendosur referuar Nenit 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Sic edhe mund të evidentohet, AK nuk i është refuzuar llojit të procedurës në fjalë “E Hapur e Thjeshtuar- Sherbim, kufirit monetar të procedurës, vlera e fondit është nën kufirin e lartë monetar dhe për rrjedhojë dhe pikën 4 të Nenit 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(I ndryshuar) ku citohet:

“4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.

Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Për sa më sipër, kërkesa për paraqitjen e bilancave, sipas pikës 2.2.2, është një kërkesë e pabazuar në ligj dhe në aktet nënligjore të prokurimit publik dhe si e tillë duhet hequr.

? Kërkesa 1:

Pika “2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet

të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.”, TË HIQET.

ANKESË 2:

AK Illyrian Guard në DST, kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, ka kërkuar, si vijon:
”2.3.2 Operatori ekonomik duhet te ketë:

? Certifikate Sistemi i Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit ISO/IEC 22301:2019 ose ekuivalent

? Certifikate për mbrojtjen e të dhënave personale në mjedise cloud ISO/IEC 27018:2019 ose ekuivalent.”

AK në hartimin e dokumentave të tenderit dhe kriterëve të vecanta për kualifikim, konkretisht tek 2.3.2 ka vendosur kriteret të pabazuar në ligj, dhe kufizuese për konkurrencën e lirë në procedurat e prokurimit publik.

Duke u nisur nga fakti që kriteret duhen argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, i drejtohem procesverbalit të argumentimit të vendosur nga AK në SPE, ku për kriterin objekt ankimi është paraqitur argumentimi si vijon:

“Argumentimi pika 2.3.2 Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, nenin 79 të LPP, nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në menaxhimin e shërbimeve në teknologjinë e informacionit. Përmeshja e standartit ISO 20000-1 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e shërbimeve që parashikon kontrata. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të shërbimeve dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmeshjen e saj sipas të gjitha standardeve të shërbimit. Sistemi i menaxhimit të shërbimeve të IT konfirmon angazhimin e operatorit ekonomik për të ofruar dhe përmirësuar vazhdimisht cilësinë e shërbimeve. Ofrimi i shërbimit, i perket fushës së teknologjisë së informacionit dhe është e nevojshme pajisja me këtë ISO nga kompania ofruese për realizimin në mënyrë efektive dhe në përputhje me kërkesat e Illyrian Guard shpk. ISO 20000-1 është standardi ndërkombëtar për Menaxhimin e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit (ITSM) i pranuar nga shumica e vendeve të botës. Standardi përshkruan një seri procesesh menaxhimi të krijuara për të ndihmuar kompanitë të ofrojnë shërbime më efektive të IT (si për ato brenda kompanisë ashtu edhe për klientët e tyre), cila jep metodologjinë dhe kornizën për të ndihmuar kompanitë të menaxhojnë ITSM. Me kërkesat e standartit kompanitë aplikojnë praktikën më të mirë, duke ndihmuar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve IT.

? ISO 27001, për menaxhimin e sigurisë së informacionit

Përmeshja e standartit ISO 27001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e të dhënave në mënyrë efektive. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik përmesh standartet për sigurinë e informacionit gjatë zbatimit të kontratës. Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përfaqëse sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria.

? Certifikate Sistemi i Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit ISO/IEC 22301:2019 ose ekuivalent

ISO/IEC 22301:2019 është standardi ndërkombëtar për Sistemin e Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit (BCMS). Ky standard ofron një kornizë të qartë për shoqëritë që duan të sigurojnë vazhdimësinë e operacioneve të tyre në rast emergjencash, ndërprerjesh apo fatkeqësish.

? Certifikate për mbrojtjen e të dhënave personale në mjedise cloud. ISO/IEC 27018:2019 ose ekuivalent

ISO/IEC 27018:2019 ose ekuivalente siguron udhëzime dhe kontrole për mbrojtjen e informacionit personal të identifikueshëm (PII) gjatë përpunimit nga ofruesit e shërbimeve cloud publike. Ky standard mbështetet në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001 dhe fokusohet në kërkesat ligjore dhe rregullatore për privatësinë në ambientet cloud. Synon të garantojë transparencë, siguri dhe kontroll mbi përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, duke parandaluar aksesin, përdorimin apo shpërndarjen e paautorizuar të tyre. Përfshin mekanizma për menaxhimin e incidenteve që ndikojnë në sigurinë e të dhënave personale.

Nga këqyrja e argumentave të paraqitura nga AK, vërejmë që nuk është kryer plotësisht argumentimi se pse kërkohen këto certifikata ISO.

Sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore si edhe udhëzimeve të APP, cdo kriter dhe kërkesë për kualifikim, duhet të shoqërohet me argumentimin përkatës nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi, duhet të përfshijë argumentimin ligjor, pra një analizë të thelluar se pse duhet kriteri në raport me detyrimet ligjore që duhet të përmbushen duke patur parasysh llojin e procedurës, fondin limit, tipin e kontratës etj.

Si edhe duhet të përfshijë argumentimin teknik, e cila duhet paraqitur si një analizë e thelluar me fakte, të dhëna dhe argumenta bindëse teknike, për të justifikuar nevojën për një certifikim të caktuar, duke patur parasysh nevojat e prokurimit, llojin e mallit apo shërbimit, lidhjen e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet realizimit të procedurës së prokurimit, përmbushjes së objektivit të prokurimit si edhe certifikatës dhe standartit që kërkohet nga AK.

Por nëse i referohemi argumentit të paraqitur nga AK për certifikatat:

? Certifikate Sistemi i Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit ISO/IEC 22301:2019 ose ekuivalent

? Certifikate për mbrojtjen e të dhënave personale në mjedise cloud. ISO/IEC 27018:2019 ose ekuivalent

vërejmë që nuk janë respektuar këto detyrime dhe është paraqitur një argument i paplotë, i pambështetur në ligj dhe i pajustificuar teknikisht, pasi nuk ka asnjë logjike teknike se pse duhen certifikimet ISO për vazhdimësinë e biznesit dhe iso për të dhënat në cloud, kur bëhet fjalë për një procedurë prokurimi e hapur e thjeshtuar ku AK kërkon të blejë një shërbim email.

Sic edhe mund të evidentohet, AK ne menyre te ekzagjeruar dhe te pajustificueshme ka vendosur te kerkoje dy certifikatat ISO/IEC 22301:2019 ose ekuivalent dhe ISO/IEC 27018:2019, perderisa ka kerkuar dhe Çertifikaten Menaxhimit te Sigurise se Informacionit ISO IEC 27001:2018 ose ekuivalent si dhe Çertifikaten e Sistemit te Menaxhimit te Sherbimit IT ISO IEC 20000-1:2011 ose ekuivalent, te cilat i perfshijne dy certifikatat ISO/IEC 22301:2019 ose ekuivalent dhe ISO/IEC 27018:2019.

AK nuk ka argumentuar se pse duhet secili nga certifikimet ISO të kërkuara.

Në këtë rast, AK nuk ka argumentuar saktë dhe në mënyrë shteruese se pse duhen këto certifikime konformiteti ISO për realizimin e kësaj procedure prokurimi. Janë të kuptueshme përgjithësisht certifikimet ISO për cilësinë, shërbimet IT apo edhe politikave për sigurinë e informacionit, por certifikimi ISO 22301:2012 "Sistemi i menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit" apo ISO/IEC 27018:2019, janë tërësisht jo koherente me këtë procedurë, pasi OE fitues do të shesë një shërbim email për AK dhe nuk do të procedojë apo të ketë akses në të dhëna që duhet të ruhen një kopje për rikuperim apo të ruhen në cloud. Këtë detyrë e kryen vetë AK, pasi AK është titullar i të dhënave të tij. OE fitues as nuk do të kryejë procedura back-up, as nuk do të ngrejë një sistem DRS dhe as nuk do të disponojë mbi asnjë aspekt të biznesit të AK apo ruajtjes së të dhënave në formë digjitale.

Prandaj, argumentimi se ISO 22301:2012 dhe ISO/IEC 27018:2019, janë të nevojshme për realizimin e procedurës së prokurimit, ËSHTË I PABAZË.

APP, në respektim të detyrave ligjore, ka udhëzuar në mënyrë të shpeshtë AK se si duhet të veprojnë në rastin e hartimit të kriterëve për kualifikim, duke e vendosur theksin në më shumë se një herë në PROPORCIONALITETIN e kriterëve dhe kërkesave për kualifikim.

Konkretisht në Shkresën Nr.4916/2.Prot datë 14.07.2022 me objekt “SJELLJE NË VËMENDJE”, faqja 3, APP iu sjell në vëmendje AK që:

“Autoritetet/entet kontraktore nuk duhet të kërkojnë:

Certifikata ISO, pa dhënë arsye konkrete për nevojën e standartit të kërkuar në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit.”

Në këtë kuptim, kërkesa nga AK për certifikatë ISO 22301:2012 dhe ISO/IEC 27018:2019 për realizimin e objektit të prokurimit, është një përcaktim jo proporcional, i pabazë, i paligjshëm dhe që nuk i shërben AK për garantimin e zbatueshmërisë së kontratës.

Përkundrazi, i shërben vetëm për të orientuar procedurën drejt një OE të caktuar, duke kufizuar kështu konkurrencën në procedurat e prokurimit publik.

Vlen të theksojmë që në rastin e ISO Sistemi i Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit ISO/IEC 22301:2019 ose ekuivalent, kjo është një ISO e pabazë dhe nuk ka asnjë lidhje me objektin e prokurimi. Ndërsa ISO për mbrojtjen e të dhënave personale në mjedise cloud ISO/IEC 27018:2019 ose ekuivalent, është një ISO që është në fushën e sigurisë së informacionit, pra të ISO 27001, ISO të cilën AK e ka kërkuar. Pra nuk mundet që për të garantuar përmbushjen e standartit të sigurisë së informacionit, të kërkohet dy certifikime, ndërkohë që ISO 27001 i përmbush dhe i tejalon këto standarte referuar edhe objektit të prokurimit.

Sa me lart kërkesa për certifikatat ISO/IEC 22301 dhe ISO/IEC 27018 janë vendosur në shkelje të nenit 44 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(I ndryshuar)

Kërkesa 2:

Pika “2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë:

?Çertifikate Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit ISO IEC 27001:2018 ose ekuivalent

?Çertifikate Sistemi të Menaxhimit të Shërbimit IT ISO IEC 20000-1:2011 ose ekuivalent

?Çertifikate Sistemi i Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit ISO/IEC 22301:2019 ose ekuivalent

?Çertifikate për mbrojtjen e të dhënave personale në mjedise cloud ISO/IEC 27018:2019 ose ekuivalent.”,

TË MODIFIKOHET DHE TË BËHET:

“2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë:

?Çertifikate Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit ISO IEC 27001:2018 ose ekuivalent

?Çertifikate Sistemi të Menaxhimit të Shërbimit IT ISO IEC 20000-1:2011 ose ekuivalent.”

PRA

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë:

Certifikate Sistemi i Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit ISO/IEC 22301:2019 ose ekuivalent

?Çertifikate për mbrojtjen e të dhënave personale në mjedise cloud ISO/IEC 27018:2019 ose ekuivalent.”,

TE HIQET

ANKESË 3:

AK Illyrian Guard në DST, kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, ka kërkuar, si vijon:

“1 (nje) punonjës të certifikuar në nivel profesional për rrjetet kompjuterike (netëork)”

AK në hartimin e dokumentave të tenderit dhe kriterëve të vecanta për kualifikim, konkretisht tek

2.3.3 ka vendosur kritere të pabazuar ne ligj, dhe kufizuese për konkurrencën e lirë në procedurat e prokurimit publik.

Për të verifikuar nëse një kriter është apo jo i nevojshëm për realizimin e procedurës së prokurimit, së pari verifikojmë objektin e procedurës së prokurimit, pra mallrat apo shërbimet që po prokurohen dhe konkretisht Formularit të Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit.

Në Formularin e Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, pjesë e DST të procedurës së prokurimit objekt ankimi, paraqiten shërbimet si më poshtë:

Shtojca 7.

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Nr	Emertimi pajisjes	Njesia	sasia	afati levrim
1	Microsoft 365 Business Standart	pakete	80	10 dite nga nenshkrimi

kontrates

Sipas tabelës së mësipërme, vërejmë që objekti i prokurimi është ofrimi i shërbimit Microsoft 365 Business Standart brenda 10 ditësh nga nënshkrimi i kontratës publike.

Në asnjë paragraf nuk përmenden shërbime apo mallra të cilat kanë të bëjnë me infrastrukturën e rrjetave kompjuterike, asnjë parashikim sipas të cilit mund të justifikohet nevoja për disponimin e një punonjësit të certifikuar për rrjetat kompjuterike, për më tepër të nivelit profesional.

Për sa më sipër rezulton se nuk ka asnjë lidhje ndërmjet objektit të prokurimit dhe kërkesës për një punonjës të certifikuar ne nivel profesional per rrjetet kompjuterike (netëork).

Duke qenë se certifikimi i kërkuar nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, certifikimi i kërkuar nga AK përbën shkelje të nenit 77 të LPP, i cili parashikon si vijon:

Neni 77

Kërkesat për kualifikim

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Pika b) e mësipërme mbi disponimin e 1 (nje) punonjës të certifikuar ne nivel profesional per rrjetet kompjuterike (netëork))” e kerkuar nga AK është një kriter i tepruar dhe jo proporcional me objektin e prokurimit, pasi referuar argumentimit të paraqitur në procesverbal, citoj:

Një punonjës i specializuar për sigurinë e rrjeteve kompjuterike (netëork) ka një rol shumë të rëndësishëm në mbrojtjen e infrastrukturës së rrjetit nga kërcënimet, ndërhyrjet dhe sulmet kibernetike. Ai punon për të siguruar që të dhënat dhe komunikimet brenda rrjetit të jenë të mbrojtura dhe të aksesueshme vetëm nga personat e autorizuar.”

Kur nderkohe nuk kemi te bejme me rrjete kompjuterike por thjesht sherbimin “E-mail Zyrtar” konfigurim te Microsoft 365 Admin Center etj, ne asnje rast ne specifikitet teknike nuk citohen rrjetet kopjuterike (netëork).

AK nuk ka argumentuar se pse duhet keto punojes bazuar ne specifikimet teknike dhe objektin e prokurimit nderkohe referuar udhezimeve dhe rekomandimeve të APP në zbatim të legjislacionit të prokurimit publik, duhet që kriteret dhe specifikimet të argumentohen ligjërisht dhe teknikisht.

Kërkesa 3:

Pika “2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor 2 punonjes, si më poshtë :

a)1 (nje) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente)

b)1 (nje) punonjës të certifikuar ne nivel professional per rrjetet kompjuterike(netëork)

Për stafin e sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë:

-Certifikatat perkatese te kursit apo trajnimit

-Duhet te figurojne ne listepagesat e kompanise E-Sig per te pakten 3 muajit e fundit.

- Nje punonjes mund te kete me shume se 1 nje certifikime/trajnime.”,

TË MODIFIKOHET DHE TË BËHET:

“2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor 1 punonjes, si më poshtë :

a)1 (nje) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente)

Për stafin e sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë:

-Certifikatat perkatese te kursit apo trajnimit

-Duhet te figurojne ne listepagesat e kompanise E-Sig per te pakten 3 muajit e fundit.

-Nje punonjes mund te kete me shume se 1 nje certifikime/trajnime.”

Sa me lart per te gjitha kriteret te cilat kundershtojme, vlen te theksojme se AK nuk ka argumentuar saktë dhe në mënyrë shteruese se pse duhen këto kriteret pasi referuar udhëzimeve dhe rekomandimeve të APP në zbatim të legjislacionit të prokurimit publik, duhet që kriteret dhe specifikimet të argumentohen ligjërisht dhe teknikisht.

Dispozitat më poshtë, e parashikojnë në mënyrë eksplicite se cfarë duhet të ketë parasysh AK në momentin e hartimit të kriterëve për kualifikim:

Neni 2

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për

operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Neni 21

Autoriteti ose enti kontraktor

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Neni 87

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

Dhe neni 45 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK, citoj;
Neni 45

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

Po ashtu vendosja e këtyre kriterëve përbën një shkelje të Kodit të Procedurave Administrative në RSH, neni 13, neni 14, citoj:

Neni 13

Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë

Në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie.

Neni 14

Parimi i objektivitetit

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën admini-strative.

Autoritet Kontraktore duhet të marrin parasysh që procedurat e tenderit duhet të jenë të formuluar në një formë që të nxisin konkurrencën e lirë mes operatorëve, sic përcakton edhe vendimi i GJED Çështja C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe

mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike.

Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”

Duke iu referuar një ndër qëllimeve kryesore të ligjit ku parashikohet se efienca, efikasiteti dhe mirëpërdorimi i fondeve publike, konkretisht neni 2, citoj:

Neni 2

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik.
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
janë postulate të padiskutueshme në referim të këtij ligji, Autoritetet Kontraktore duhet të mbajnë parasysh që të prokurojnë mallra shërbime punë në mënyrë sa më efektive duke përfituar një cmim sa më të ulët.

Dhe cmimet e ulta dhe konkurrenca e bën një procedurë ku ofron shance të barabarta për të gjithë ofertuesit e mundshëm, pra duke mos aplikuar kritere përjashtuese, kritere që nuk kanë lidhje me objektin e procedurës së prokurimit dhe/ose kritere që orientohen drejt një ofertuesi të caktuar apo një grupi ofertuesish, që automatikisht kufizon konkurrencën, rrjedhimisht duke bërë që të ofrohen cmime më të larta.

Kjo sjellje bie ndesh edhe me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH, konkretisht Ligjin Nr.9936, Datë 26.6.2008 Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ku parashikohet se institucionet duhet të kenë parasysh përdorimin eficient të fondeve publike, konkretisht neni 3 dhe neni 4 i ligjit, citoj:

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termit e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Buxhet” është tërësia e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore e vendore dhe të fondeve speciale, të cilat miratohen me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë, më poshtë “Kuvendi” ose me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 4

Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor

Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor janë:

ç) përdorimi ekonomik, eficient dhe efektiv i burimeve publike;

ku përcaktimi në ligj është shterues që është detyrë kryesore e institucioneve mirëmenaxhimi i fondeve publike. Në këtë kuptim, AK, duke kufizuar konkurrencën, automatikisht keqmenaxhon edhe fondet publike.

Gjithashtu Autoritetet Kontraktore duhet të marrin parasysh edhe udhëzimet/rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik, direktiva të cilat instruktojnë në mënyrë të saktë dhe shteruese se si

duhet vepruar në praktikat e prokurimit publik.

Konkretisht, në Rekomandimin Nr.7998 të datës 24.12.2021, Agjencia e Prokurimit Publik e vë edhe një herë theksin të rëndësia e hartimit të kriterëve të kualifikimit në harmoni me procedurën e tenderit, citoj:

5. Sjellim në vëmendje të autoriteteve/enteve kontraktore që kërkesat për kualifikim duhet në cdo rast të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës që prokurohet.

Nga asistimet e deritanishme, APP ka konstatuar se AK përcaktojnë te kriteret e vecanta të kualifikimit kërkesa që nuk kanë lidhje me objektin e kontratës, ose që tejkalojnë nevojat për zbatimin me sukses të kontratës.

Në rast konkret në lidhje me këtë problematikë, lidhet me kontratat e punëve, ku AK përcaktojnë shpesh kërkesa për kategori në licencën profesionale për zbatimin e punimeve të ndërtimit, të cilat nuk përputhen me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen dhe që janë të përfshira në preventivin e punimeve, apo kërkesa që kategoritë e kërkuara të kenë nivele klasifikimi që e tejkalojnë vlerën e punimeve sipas kategorisë përkatëse, apo edhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Pra Agjencia e Prokurimit Publik (APP) në rekomandimin e sipërcituar, e vë theksin për të disatën herë tek proporcionaliteti i kriterëve me objektin e procedurës së prokurimit, duke iu bërë me dije AK që cënimi i këtij raporti proporcional është cënim në vetvete i gjithë procedurës dhe legjislacionit të prokurimit publik.

Për të konkluduar PC Store shpk në vazhdim të arsyetimit të paraqitur më lart, i gjykon më se të drejta e të ligjshme pretendimet e paraqitura.

Për sa kemi paraqitur më sipër, në dritën e fakteve, bazuar në legjislacionin përkatës, përfundimisht kërkojmë:

1. Pranimin e ankesës sonë.

2. Pika “2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”, TË HIQET.

3. Pika “2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë:

Çertifikate Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit ISO IEC 27001:2018 ose ekuivalent

Çertifikate Sistemit të Menaxhimit të Sherbimit IT ISO IEC 20000-1:2011 ose ekuivalent

Certifikate Sistemi i Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit ISO/IEC 22301:2019 ose ekuivalent

Certifikate për mbrojtjen e të dhënave personale në mjedise cloud ISO/IEC 27018:2019 ose ekuivalent.”,

TË MODIFIKOHET DHE TË BËHET:

“2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë:

Çertifikate Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit ISO IEC 27001:2018 ose ekuivalent

Çertifikate Sistemit të Menaxhimit të Sherbimit IT ISO IEC 20000-1:2011 ose ekuivalent.”

PRA

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë:

Certifikate Sistemi i Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit ISO/IEC 22301:2019 ose ekuivalent

?Certifikate për mbrojtjen e të dhënave personale në mjedise cloud ISO/IEC 27018:2019 ose ekuivalent.”,

TE HIQET

4. Pika “2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor 2 punonjes, si më poshtë :

a) 1 (nje) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente)

b) 1 (nje) punonjës të certifikuar ne nivel professional per rrjetet kompjuterike(netëork)

Për stafin e sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë:

-Certifikatat perkatese te kursit apo trajnimit

-Duhet te figurojne ne listepagesat e kompanise E-Sig per te pakten 3 muajit e fundit.

- Nje punonjes mund te kete me shume se 1 nje certifikime/trajnime.”,

TË MODIFIKOHET DHE TË BËHET:

“2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor 1 punonjes, si më poshtë :

a) 1 (nje) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente)

Për stafin e sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë:

-Certifikatat perkatese te kursit apo trajnimit

-Duhet te figurojne ne listepagesat e kompanise E-Sig per te pakten 3 muajit e fundit.

-Nje punonjes mund te kete me shume se 1 nje certifikime/trajnime.”

5. Modifikimin e dokumentave të tenderit.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme ☐

Po ☐

Jo ☒

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

NA

7. Lista e informacionit konfidencial: ☐

NA

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes. ☐

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

financa@pcstore.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Vitator Mehmeti